



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health

**STRATEGJIA E PËRMIRËSIMIT TË CILËSISË DHE
SIGURISË SË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE
2012-2016**

Prishtinë, 2012

PËRMBAJTJA

Parathënie

Lista e shkurtesave

1. Hyrja
2. Arsyeshmëria
3. Faktorët mbështetës
4. Vlerat udhëheqëse
5. Parimet udhëheqëse
6. Vizioni
7. Misioni
8. Synimet
9. Objektivat
 - 9.1. Objektiva strategjike 1
Institucionalizimi i cilësisë dhe sigurisë në sistemin shëndetësor
 - 9.2. Objektiva strategjike 2
Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, performancës dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore në institucione dhe praktikën mjekësore
 - 9.3. Objektiva strategjike 3
Akreditimi i institucioneve shëndetësore në përputhje me standardet e përcaktuara
 - 9.4. Objektiva strategjike 4
Zbatimi i praktikës më të mirë klinike të bazuar në evidencë shkencore
 - 9.5. Objektiva strategjike 5
Vendosja e pacientëve në qendër të sistemit shëndetësor
 - 9.6. Objektiva strategjike 6
Shërbimet shëndetësore cilësore të kontraktuara
10. Monitorimi i zbatimit të Strategjisë
11. Përfundim
12. Referenca

PARATHËNIE

Cilësia dhe siguria e shërbimeve shëndetësore nuk është koncept i ri në sistemin shëndetësor të Kosovës. Ajo ka zanafillën nga standardet dhe normativat e sistemit shëndetësor që janë aplikuar që nga vitet e shtatëdhjeta të shekullit të kaluar. Që nga kjo kohë zbatimi i konceptit të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore në Kosovë pati ngritjet dhe rëniet duke reflektuar zhvillimet politike, ekonomike dhe sociale në vend.


Qeveria e Republikës së Kosovës në kuadër të Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë 2010-2014, shpreh përkushtimin për përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore. Ky dokument strategjik paraqet rrugëtimin drejt qëndrueshmërisë së mekanizmave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore duke vënë në qendër kërkesat dhe nevojat e shfrytëzuesve dhe ofruesve të shërbimeve shëndetësore. Zbatimi i këtij dokumenti brenda resurseve financiare të kufizuara nënkupton balancin optimal midis mundësive dhe vlerave të definuara në këtë dokument.

Cilësia dhe siguria e shërbimeve shëndetësore janë rezultat i interaksionit që udhëhiqet nga rregullat për të komunikuar përkitazi me këto veçori esenciale të shërbimeve shëndetësore. Këto rregulla përmirësojnë aftësitë tona për të diskutuar dhe debatuar për cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve shëndetësore, që mëtuje na mundëson definimin e aktiviteteve për t'i përmirësuar ato.

Cilësia dhe siguria e shërbimeve shëndetësore po bëhen gjithnjë e më të ndërlidhura midis shteteve në regjion dhe më gjërë. Kjo padyshim është rrjedhojë e nivelit të shtuar të pritjeve për shëndetin nga ana e qytetarëve, lëvizjeve të pacientëve dhe të profesionistëve shëndetësorë, si dhe zhvillimit të hovshëm të teknologjisë mjekësore dhe informative.

Ky dokument ndërlidh avancimin e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore në Kosovë me zhvillimet dhe rrjedhat e përmirësimit të gjithëmbarshtëm të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore në Bashkimin Europian, duke i dhënë reformës përmbajtësore të sistemit shëndetësor në vend mbështetje të fuqishme në standarde të dëshmuara ndërkombëtare.

Shtator 2012
Prishtinë



Prof. Dr. Sci Ferid Agani
Ministër i Shëndetësisë

LISTA E SHKURTESAVE

AKPSH	Agjensioni për Komisionimin e përkujdesjes shëndetësore
DCSLA	Divizioni për Cilësi, Siguri, Licencim dhe Akreditim
DMS	Departamenti për menaxhim Strategjik
DSHSH	Departamenti për shërbime shëndetësore
IEK	Informim, Edukim dhe Komunikim
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
KKUPK	Këshilli Kosovar për udhërrëfyes dhe protokolle klinike
KPSH	Kujdes parësor shëndetësor
QKMF	Qendra kryesore e mjekësisë familjare
QZHMF	Qendra për zhvillimin e mjekësisë familjare
SISH	Sistemi i informimit shëndetësor
SSSH	Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë
UPK	Udhërrëfyesit dhe protokollat klinike